

**LIGJI NR. 06/L - 121**

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-097 PËR BIBLIOTEKAT**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-097 PËR BIBLIOTEKAT**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 04/L-097 për Bibliotekat.

**Neni 2**

Neni 25 i ligjit bazik, ndryshohet si në vijim:

**Neni 25**  
**Gjoha**

1. Me gjobë prej njëqind (100) euro deri dymijë (2.000) euro dënohet për kundërvajtje përdoruesi që nuk e kthen, e dëmton, tjetëron ose e asgjëson materialin bibliotekar ose në ndonjë mënyrë tjetër shkel rregullat e përdorimit të materialit bibliotekar, ndërsa personi juridik nga pesëqind (500) euro deri në njëzetëmijë euro (20.000) euro.

2. Me gjobë prej dyqind (200) euro deri dymijë (2.000) euro dënohet për kundërvajtje drejtuesi i bibliotekës nëse nuk ia dërgon Bibliotekës Kombëtare të Kosovës të dhënat e duhura.

3. Me gjobë prej pesëqind (500) euro deri njëzetëmijë (20.000) euro dënohet për kundërvajtje botuesi, përkatësisht subjekti që nuk kryen obligimin e dërgimit të ekzemplarit të detyrueshëm në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës.

4. Me gjobë prej dyqind (200) euro deri dymijë (2.000) euro dënohet për kundërvajtje personi përgjegjës i bibliotekës së sektorit publik i cili nuk ia dërgon Bibliotekës Kombëtare të Kosovës listën e koleksioneve të bibliotekës të cilat janë nxjerrë nga përdorimi apo listën e koleksioneve të bibliotekës që ka pushuar së funksionuari.

5. Me gjobë prej pesëqind (500) euro deri dymijë (2.000) euro dënohen për kundërvajtje personat fizik që posedojnë materiale bibliotekare me rëndësi për trashëgiminë kulturore të cilët nuk e njoftojnë Bibliotekën Kombëtare të Kosovës për tjetërsimin e tyre, ndërsa personat juridik dënohen nga njëmijë (1.000) euro deri në njëzetëmijë (20.000) euro.

**Neni 3**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 06/L-121**  
**30 maj 2019**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-123-2019, datë 21.06.2019 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi**